

VENDIM
Nr. 553, datë 1.10.2025

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 79, DATË 31.1.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM, NJËSIA
ADMINISTRATIVE 1, ZONA AUTOTRAKTORI, BASHKIA TIRANË, DHE
CAKTIMIN E SHOQËRISË ‘TIRANA DC’ SHA, SI NJËSI ZBATUESE”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nënndarjeve “iii” e “iv”, të shkronjës “b”, të nenit 13, dhe të pikës 3, të nenit 16, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 79, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim, Njësia Administrative 1, zona Autotraktori, Bashkia Tiranë, dhe caktimin e shoqërisë ‘Tirana DC’ sh.a., si njësi zbatuese”, të ndryshuar.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë, shoqëria “Tirana DC” sh.a. dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama